

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Adelina Brestovci, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. A., nga Gj., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Y. H., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>1</sup> dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.173/2016, i datës 29 korrik 2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 3 gusht 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse, më datën 12 gusht 2016, e përpilojë me shkrim këtë :

## AKTGJYKIM

I pandehuri K. A., nga babai R. dhe e nëna H., e lindur M., i lindur më ..., në fshatin S., Komuna e N., tani me vendbanim në Gj., rruga "...", shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, invalid pune në Z., i martuar, babë i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale,

## ËSHTË FAJTOR

## I.

Sepse në kohë të përcaktuar më parë, i pandehuri në shtëpinë e tij në Gjilan, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit, ashtu që më datën ... 2016, rreth orës ... minuta, nga Njësiti reagues "...", në Gjilan, i është gjetur dhe sekuestruar arma e zjarrit, e markës "...", ngjyrë e ..., me ... karikator dhe ... fishekë të kalibrit ... mm,

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK,

## II.

Sepse më datën ... 2016, rreth orës ... minuta, në Gj., në rrugën "...", në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, i pandehuri në fidanishten "...", pronë e të dëmtuarit S. A., nga fshati L. i E., Komuna e Gj., ka përdorur armën e zjarrtë-revolen e markës "...", të cilën e ka nxjerr nga brezi në drejtim të dëmtuarit, duke e kërcënuar dhe shqetësuar, në atë mënyrë që tek i njëjti ka krijuar një shqetësim dhe ankth, duke ja bërë jetën të pasigurtë,

- me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues në bazë dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 69, 73, 74, 75, 76 dhe 83 të KPRK, si dhe neneve 247 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të pandehurit i shqipton :

### DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ËSHTË ZËVENDËSUAR NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit K. A., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro), kurse, për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK, sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, i caktohet dënimi me gjobë në shumën prej 400 € (katërqind Euro) dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve.

Me pëlqimin e të pandehurit K. A., dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind Euro).

Meqë të pandehurit K. A., i janë shqiptuar 3 (tri) dënime me gjobë (400 €, 400 € dhe 700 €), atëherë, ndaj tij shqiptohet një dënim unik me gjobë në shumë prej 1,500 € (Njëmijepesëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri, do ta paguajë në afat prej 6 (gjashtë) muajve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

---

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë, dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

Konfiskohet arma e zjarrit, e markës “...” ngjyrë e ..., me ... karikator dhe ... fishekë të kalibrit ... mm.

Koha e kaluar në paraburgim prej datës ...korrik 2016 e deri më datën ... korrik 2016, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës ... korrik 2016 e deri më datën ... gusht 2016, të pandehurit K. A., i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, ashtu që 1 (një) ditë e privimit nga liria do të barazohet me 20 € (Njëzet Euro) të dënimit me gjobë.

I dëmtuari S. A., nga fshati L. i E., Komuna e Gj., për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri K. A., që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## ARSYETIMI

### 1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 29 korrik 2016 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit K. A., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK.

Pas ngritjes së aktakuzës dhe pas caktimit të seancës fillestare, në këtë Gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë, e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, në njërën anë, si dhe të akuzuarit K. A. dhe mbrojtësit të tij, në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje, trupit gjykues i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit t'i caktohet për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro), ndërsa, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 400 € (katërqind Euro)

dhe dënimi me burg në kohëzgjate prej 5 (pesë) muajve, me mundësi të zëvendësimit në dënim me gjobë.

## 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën ... gusht 2016, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin Y. H., se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanta e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri K. A., me dashje i ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprave penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla”, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenet 17 deri 32 të Ligjit për armët,<sup>3</sup> është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë,<sup>4</sup> duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Kurse, në nenin 375 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar njëra prej formave të kualifikuara të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, të cilën konsiderohet se e kryen

<sup>3</sup> Ligji nr.05/L-022 për Armët, i datës 23 korrik 2015.

<sup>4</sup> Duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 38 të KPRK, shprehja “armë”, përveç tjerash, përfshinë edhe municionin, pjesët e armëve dhe përbërësit e armëve.

“personi që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese” dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënim me gjobë deri në 10.000 € (dhjetëmijë Euro) dhe me burim prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet.

#### 5. Vendimi për shpalljen fajtor të të pandehurit

Kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin K. A., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Kryetari i trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimeve, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit K. A., me të cilën është parashikuar shqiptimi i dënimeve të lartcekura dhe mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 deri 76 të KPRK. Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka shqiptuar dënimin, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale; se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, i njëjti është i martuar dhe është babë i ... fëmijëve, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk është dënuar për ndonjë vepër tjetër penale nga Departamenti i Krimeve të Rënda. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Po ashtu, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjenden pasurore të të pandehurit.

Ndërsa, kryetari i trupit gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese ndaj të pandehurit.

#### 7. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit K. A., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK, me pëlqimin e të pandehurit K. A., dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind Euro), duke i marrë për bazë rrethanat e lartcekura. Meqë të pandehurit K. A., i janë shqiptuar 3 (tri) dënime më gjobë (400 €, 400 € dhe 700 €), atëherë, ndaj tij shqiptohet një dënim unik me gjobë në shumë prej 1,500 € (Njëmijepesëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri, do ta paguajë në afat prej 6 (gjashtë) muajve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

#### 9. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

#### 10. Dënimi plotësues

Duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1, si dhe nënin 374 paragrafi 3 të KPRK, kryetari i trupit gjykues, krahas dënimit kryesor, ndaj të pandehurit K. A., ka vendosur që të shqiptojë edhe dënimin plotësues – konfiskimin e armës së zjarrit, e markës “...” ngjyrë e ..., me ... karikator dhe ... fishekë të kalibrit ...mm.

#### 11. Vendimi për llogaritjen e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak

Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 83 të KPRK, ka vendosur që koha e kaluar në paraburgim prej datës ... korrik 2016 e deri më datën ... korrik 2016, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës ... korrik 2016 e deri më datën ... gusht 2016, të pandehurit K. A., t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, ashtu që 1 (një) ditë e privimit nga liria do të barazohet me 20 € (Njëzet Euro) të dënimit me gjobë.

#### 12. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin S. A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike t'a udhëzojë në kontest civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, të kërkesës pasurore juridike.

#### 13. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (Njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 12 gusht 2016

Sekretarja juridike,  
Adelina Brestovci

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e as për shkak të vendimit për dënimin.